



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2751/2 prot.,

Datë 09.11.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*BNT ELECTRONICS*” SHPK në procedurën e prokurimit “*E Hapur e Thjeshtuar - Mallra*”, me Nr. *REF-83568-10-12-2023*, me objekt: “*Blerje ECHO KARDIAKE*”, me fond limit 2.500.2000 lekë pa TVSH zhvilluar më datë 23.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Mat.

Ankimues: Operatori ekonomik “*BNT ELECTRONICS*” SHPK me NIPT: J61817047D, dhe me adresë: *Bulevardi “Zhan D’ark”, Nd.32, Hyrja 16, Kati 2, Ap.1, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Shërbimit Spitalor Mat
Adresa: Lagjja “Drita”, KP 8001, Burrel.

Në datën 08.11.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. *A/2023/3577* dhe me nr. *2751/2023* protokollit, datë 08.11.2023 e operatorit ekonomik “*BNT ELECTRONICS*” SHPK për procedurën e prokurimit “*E Hapur e Thjeshtuar - Mallra*”, me Nr. *REF-83568-10-12-2023*, me objekt: “*Blerje ECHO KARDIAKE*”, me fond limit 2.500.2000 lekë pa TVSH zhvilluar më datë 23.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Mat..

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*BNT ELECTRONICS*” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:
b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “BNT ELECTRONICS” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 2751 prot., datë 08.11.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

“Oferta juaj është refuzuar.

arsye:

- *Mungon tastiera me ndricim interaktiv.*
- *thellessia e skanimimit te sodnes mungon.*
- *Modalitetet e skanimimit 2b, 4b, b/bc mungojne.*
- *Ne modalitetin PW mungon parametri i autokalkulimit.*
- *Formati i imazhit 1:1, 2:2 mungon.*
- *Nuk ka te dhena mbi frame rate te Bmode apo Cmode.”.*

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 09.11.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar
Fiorent Zguro**